



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA**

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE**

**Nr. i Dokumentit: 22.27.1-2016-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**

**PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË KOMUNËS SË  
LEPOSAVIQIT PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

**Prishtinë, qershor 2017**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Leposaviqit, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrë auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqës i ekipit, Xhevat Seferi dhe anëtarët e ekipit Milosh Petroviq e Nebojsa Ristiç, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Zukë Zuka.

## TABELA E PËRMBAJTJES

|  |    |
|--|----|
| Përmbledhje e përgjithshme .....   | 4  |
| 1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm ..... | 7  |
| 2 Qeverisja.....   | 11 |
| 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....  | 17 |
| Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit .....                                | 28 |
| Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA..... | 29 |
| Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak .....          | 31 |
| Shtojca IV: Letër e Konfirmimit .....  | 36 |

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky Raport përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Komunës së Leposaviqit për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit<sup>1</sup>, të datës 07.11. 2016.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Më gjerësisht, shih Shtojcën 1

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale, përveç çështjes në vijim:

Pagesat në avans për investime kapitale në vlerë prej 75,336€ kishin tejkaluar limitet e përcaktuara (mbi 15%) me ligjin e buxhetit 2016.

#### *Theksimi i çështjes*

Komuna, përkundër progresit të bërë, nuk ka arritur të regjistroj dhe shpalosë në Pasqyrat Financiare Vjetore të gjitha pasuritë e blera gjatë vitit 2016 dhe nga vitet e mëparshme; dhe

Dosjet, përkatësisht kontratat e punës për 65 punonjës të administratës komunale nuk janë azhurnuar. Komuna nuk ka ofruar kontrata të reja për punonjësit që kishin kontrata pune që nga administrimi i UNMIK-ut.


Për më gjerësisht, shih kapitullin 1.1 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

<sup>1</sup> Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimit të Auditimit”

Dëshirojmë të falënderojmë Kryetarin dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

### Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



### **Përgjigja e Kryetarit të Komunës**

Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. Më tutje Kryetari i Komunës është zotuar që:

- ta shqyrtoj Raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- deri në fund të muajit janar 2018, ta diskutoj në Asamblenë Komunale progresin lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PFV 2017 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

# 1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

## Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

## 1.1 Opinioni i auditimit

### Opinioni i kualifikuar me theksim të çështjes

Kemi audituar PFV-të e Komunës së Leposaviqit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësim dhe ndryshime) dhe Rregullore MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

### Baza për opinion të kualifikuar

Shpenzimi për projektin: “Mbështetja për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe zhvillimi i bujqësisë” në vlerë 75,336€ ishte paguar në mënyrë të pa rregullt si avans<sup>2</sup>. Kjo pagesë përbën gabim material pasi pagesat në avans për investime është e lejuar vetëm deri në 15% të vlerës së kontratës, ndërsa është paguar 79% e kontratës.

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa ‘Përgjegjësitë e Auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare’. Sipas kërkesave etike, të cilat janë

---

<sup>2</sup> Projekti për Zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, i kontraktuar me operatorin “Agjencinë Rajonale për zhvillim-Veri (RDA North).

---

relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore në Kosovë, ZKA është i pavarur nga Komuna dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

### **Theksimi i çështjes**

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se komuna, edhe pse ka shënuar progres në regjistrimin e pasurisë, nuk ka regjistruar dhe shpalosur në PFV të gjitha pasuritë e blera gjatë vitit 2016. Po ashtu pasuritë e blera dhe të trashëguara në vitet e mëparshme nuk janë prezantuar në këto pasqyra. Më tutje, pasuritë e paraqitura në PFV nuk janë regjistruar në SIMFK, si dhe nuk është duke u përdorur sistemi e-pasuria për regjistrimin e pasurisë me vlerë nën 1000€; dhe

Nuk janë azhurnuar dosjet, përkatësisht kontratat e punës për 65 punonjës të administratës së komunës. Komuna nuk ka ofruar kontrata të reja për punonjësit që punojnë që nga koha e administrimit të UNMIK-ut.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të**

Menaxhmenti i komunës së Leposaviqit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo

---



gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## 1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga organizata buxhetore kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Kërkesat buxhetore të Ligjit për buxhetin e Kosovës nr.05/L-071, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.05/L-109 për rishikim buxhetor;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK); dhe
- Kërkesat tjera për raportime buxhetore, siç janë raportet tremujore duke i përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntëmujore me kohë; raportet operative (të performancës), nëse ka;
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit më kohë.

Në kontekst të PFV-ve, çështjet në lidhje me kornizën raportuese, nuk ishin adresuar me rastin e përgatitjes së draft Pasqyrave financiare, ku kemi identifikuar mos-pajtueshmërinë në vijim:

- Neni 13. Pasqyra e pranimeve dhe pagesave ne para të gatshme;
- Neni 14 Raporti i Ekzekutimit të buxhetit; dhe
- Gabimet në pjesën e shpalosjeve dhe shënimeve Neni: 15, 19, 21, 22, 24, 26 dhe 28.

Pas sugjerimeve tona këto pasqyra financiare janë korrigjuar, përveç Nenit 19 lidhur me vlerësimin dhe shpalosjen e saktë të pasurive kapitale, jo-kapitale dhe stoqeve të materialit shpenzues. Këto çështje përbëjnë bazën për theksimin e çështjes.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë, përveç çështjeve të paraqitura në opinionin e auditimit.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

### 1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Për çështjet e sipër përmendura jepet rekomandimi:

**Rekomandimi 1** Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Kualifikim dhe Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i evituar gabimet e pagesave në avanc, menaxhimin e personelit dhe vlerësimin e saktë të pasurive. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

---

## 2 Qeverisja

### Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për komunën që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një OB të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për të përcaktuar cilësinë e listave kontrolluese të plotësuara për vet-vlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e themelimit dhe funksionimit të sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive në sistemin e qeverisjes, veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Lista kontrolluese e vet-vlerësimit, nuk është plotësuar nga komuna. Për më tepër, as aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe themelimi i sistemit të auditimit të brendshëm, nuk janë kryer.

Komuna në përgjithësi nuk ka kontrolle të mira në raport me obligimet statutorë të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli nuk ka dëshmuar se ka një proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Qeverisja në Komunë në lidhje me raportimin menaxherial dhe llogaridhënien, si dhe menaxhimin e rrezikut pasqyron një situatë ku vërehet se komuna nuk ka zbatuar pjesën më të madhe të rekomandimeve si dhe nuk ka përgatitur regjistrin e rreziqeve për të identifikuar kërcënimet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj.

Auditimi i Brendshëm nuk është themeluar ende, kështu që niveli i sigurisë së kontrolleve të brendshme është i ulët.

Në vitin 2016, komuna ka përdorur 84% të buxhet final me një përmirësim për 5% në krahasim me vitin paraprak. Kjo tregon një trend pozitiv në realizimin e buxhetit.

Gjithashtu, edhe në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin, auditimi ynë ka shpalosë ekzistencën e disa dobësive të cilat përfshinë kryesisht prokurimin, si rezultat i mos zbatimit të rregulloreve të prokurimit, mos zbatimin e rregullave të shërbimit civil nga personeli, mungesa e rregulloreve për dhënien e subvencioneve dhe arkëtimin e të hyrave.

## 2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2015 të Komunës ka rezultuar me 17 rekomandime. Menaxhmenti kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqet mënyrës se si do të zbatohen rekomandimet. Raporti i auditimit nuk ishte diskutuar në Kuvendin Komunal, ashtu siç është kërkuar në raportin e vitit të kaluar.

Deri në fund të auditimit, dy (2) rekomandime janë zbatuar; tre (3) janë adresuar dhe dymbëdhjetë (12) nuk janë zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Shtojcën III.

### Çështja 2 – Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

**E gjetura** Vetëm dy prej 17 rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar. Menaxhmenti nuk ka zbatuar ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm (AP).

**Rreziku** Mos implementimi i plotë i rekomandimeve ka rezultuar në:

- Cilësinë e dobët e raportimit të brendshëm dhe të aktiviteteve tek menaxhmenti i lartë; dhe
- Dobësi në zbatimin e rregulloreve të prokurimit, rregullave të shërbimit civil nga personeli, mungesa e rregulloreve të brendshme për dhënien e subvencioneve dhe arkëtimin e të hyrave.

**Rekomandimi 2** Kryetari duhet të sigurojë se do të zbatohet një proces i forcuar i llogaridhënies së stafit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, sipas afateve kohore dhe prioriteteve të përcaktuara me planin e veprimit. Monitorimi i progresit të rekomandimeve duhet të bëhet në mënyrë sistematike.

---

## 2.2 Pyetëtori i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi vërejtur se plotësimi i pyetëtorit të vet-vlerësimit të MFK-së nuk është kryer dhe dorëzuar në Ministri. Lidhur me këtë, ne kemi përmbledhur të gjeturat tona më poshtë.

---

### Çështja 3 – Pyetëtori i vet-vlerësimit – Prioritet i lartë

#### E gjetura

Si rezultat i rishikimeve tona, kemi gjetur se:

- Pyetëtori i vet-vlerësimit të komunës nuk është plotësuar nga menaxhmenti i komunës, dhe kjo konfirmon se sistemet e menaxhimit të rrezikut nuk ishin ende funksionale. Kjo situatë ka ndodhur për shkak se nuk janë ndërmarr hapat fillestar në këtë fushë;
- Proceset efektive të monitorimit si dhe strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit (përfshirë ndërlidhjen me palët e interesit si dhe sigurimin e strategjisë me kosto të plotë) nuk janë vendosur nga menaxhmenti i Komunës; dhe
- Lidhjet në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit si dhe përpilimi i raporteve adekuate në baza të rregullta kohore nuk janë vendosur, si dhe raportet nuk janë përpiluar gjithmonë në baza të rregullta kohore.

Kjo është rezultat i mungesës së qartësisë së menaxhmentit që ka të bëjë me rëndësinë e kësaj liste kontrolluese dhe me atë se kush është zyrtari përgjegjës që i përdorë këto mekanizma për t'i mbështetur përmirësimet operative.

#### Rreziku

Aranzhimet e dobëta të qeverisjes ndikojnë në dobësimin e proceseve strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefektive.

#### Rekomandimi 3

Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarr veprimi për plotësimin e listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Më pas, duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.

---

## 2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit Komuna operon dhe sfidat me të cilat përballet.

### 2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike

Të gjitha organizatat buxhetore (komuna) janë të obliguara të përgatisin dhe të përcjellin planet strategjike në nivel të organizatës, si: Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal, Strategjinë për Zhvillim Rural Lokal, Strategjinë e Zhvillimit të Turizmit, Plani Strategjik për Zhvillimin e Arsimit Para universitar, Plani i Mirëmbajtjes së Hapësirave Publike, Plani Zhvillimor Komunal, Plani i Rregullues Urban, etj.

---

#### Çështja 4 - Mungesa e planeve strategjike - Prioritet i lartë

- |                      |   |
|----------------------|---|
| <b>E gjetura</b>     | Komuna nuk ka një strategji të përgjithshme të objektivave dhe planeve tjera operative, nuk ka qartësuar përgjegjësitë për koordinimin dhe zhvillimin e planit strategjik, urbanistik dhe hapësitor, që do të përfshinte edhe llogaritjen e kostove të strategjisë. |
| <b>Rreziku</b>       | Mungesa e një strategjie të përgjithshme të zhvillimit dhe planeve tjera zhvillimore, bënë të pamundur që të përcillet dhe matet përmbushja e objektivave afatgjata dhe vjetore, si një ndër kushtet esenciale të qeverisjes së mirë.                               |
| <b>Rekomandimi 4</b> | Kryetari duhet të siguroj hartimin e një strategjie të përgjithshme zhvillimore, si dhe të hartoj planin e veprimit për monitorimin e arritjes së objektivave duke vendosur funksione efektive të mbikëqyrjes.  |

---

## 2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

---

### Çështja 5 – Dobësi në kontrollet menaxheriale – Prioriteti i lartë

- E gjetura** Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ka nxjerrë në pah një raportim të dobët financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat tek menaxhmenti i lartë, si dhe analiza të pakompletuara të ofrimit të shërbimeve. Kjo ka ndodhur për shkak se formati i raporteve menaxheriale nuk ofron shpjegime rreth ndryshimeve në buxhet dhe se parashikimet buxhetore nuk janë azhurnuar në baza mujore. Ngjashëm, synimet operative nuk menaxhohen në mënyrë sistematike.
- Rreziku** Cilësia e dobët e raportimit financiar dhe të aktiviteteve tek menaxhmenti i lartë redukton aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar aktivitetet e Komunës në mënyrë pro aktive si dhe ulë efektin e kontrolleve buxhetore. Kjo mund të rezultojë në deficit ose suficit të paplanifikuar dhe të vonojë veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato. Kjo gjithashtu mund të bëjë që të hyrat të mos arkëtohen siç pritet. Ngjashëm mund të rezultojë edhe në ofrimin e shërbimeve jo cilësore.
- Rekomandimi 5** Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme brenda muajve në vijim.

---

## 2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Organizatat buxhetore janë të obliguara që të sigurojnë që aktivitetet dhe proceset e saj t'i nënshtrohen auditimit të brendshëm. Një sistem i mirëfilltë i auditimit të brendshëm i ndihmon menaxhmentit në identifikimin e dobësive në menaxhimin financiar dhe kontrolleve të komunës. Kjo i shton vlerë parasë së shpenzuar dhe kontribuon në arritjen e objektivave dhe përmirësimin e shërbimeve që ofron komuna.

---

### Çështja 6 - Mos themelimi dhe funksionalizimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NjAB) - Prioriteti i lartë

- E gjetura** Komuna ende nuk ka arritur që të siguroj shërbimet e auditimit të brendshëm. Gjithashtu nuk e ka themeluar as Komitetin e auditimit, ndonëse kjo ishte rekomanduar vazhdimisht nga AP. Kjo ka ndodhur për shkak se menaxhmenti i komunës nuk i ka kushtuar rëndësinë e duhur auditimit të brendshëm në përmirësimin e aktiviteteve të komunës.
- Rreziku** Mungesa e rishikimeve të rregullta të auditimit të brendshëm mund të ndikojë në vazhdimin e përsëritjes së dobësive në sistemet kyçe të kontrollit të brendshëm. Për më tepër, menaxhmenti mund të mos jetë në gjendje që me kohë t'i identifikojë dobësitë e kontrolleve dhe të reagojë për eliminimin e tyre.
- Rekomandimi 6** Kryetari duhet të merr në konsiderim themelimin e NjAB-së i cili përmes një programi gjithëpërfshirës të punës do të inkorporonte rreziqet financiare dhe të tjera të komunës dhe do të vlerësonte efektivitetin e kontrollit të brendshëm.



### 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

#### Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin 2, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

#### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Sa i përket Komunës, prokurimi mbetet shqetësim i madh, ku nuk janë duke u zbatuar rregulloret duke rezultuar në vlerë të dobët të arritur për para si dhe në vonesat e përfundimit të projekteve. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë realizimi i buxhetit, posaçërisht për kategorinë e investimeve kapitale si dhe përmirësime tek planifikimi dhe arkëtimi i të hyrave.

#### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Të hyrat vetjake (në €)**

| Përshkrimi                       | Buxheti fillestar | Buxheti Final | 2016 Pranimet | 2015 Pranimet | 2014 Pranimet |
|----------------------------------|-------------------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| Të hyrat e arkëtuara nga komuna  | 42,888            | 50,000        | 2,078         | 1,623         | 1,630         |
| Gjobat e policisë                | 0                 | 0             | 20,022        | 17,776        | 12,347        |
| Gjobat e gjykatave               | 0                 | 0             | 280           | 475           | 370           |
| <b>Gjithsej të hyrat vetjake</b> | <b>42,888</b>     | <b>50,000</b> | <b>22,380</b> | <b>19,874</b> | <b>14,764</b> |

Të hyrat vetjake, janë planifikuar për investime kapitale. Megjithatë, nga këto të hyra nuk ka pasur fare shpenzime në vitin 2016. Arkëtimi i ulët të hyrave vetjake, tregon një performancë të dobët dhe angazhim joserioz nga menaxhmenti i komunës. Pavarësisht bartjes së të hyrave nga periudha paraprake dhe inkasimit gjatë vitit aktual, komuna nuk kishte bërë asnjë shpenzim nga këto burime.

**Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

| Përshkrimi                                  | Buxheti fillestar | Buxheti Final <sup>3</sup> | 2016 Realizimi   | 2015 Realizimi   | 2014 Realizimi   |
|---|-------------------|----------------------------|------------------|------------------|------------------|
| <b>Burimet e Fondeve:</b>                   | <b>3,402,869</b>  | <b>4,227,337</b>           | <b>3,425,423</b> | <b>2,698,312</b> | <b>2,263,758</b> |
| Granti i Qeverisë -Buxheti                  | 3,359,981         | 3,687,879                  | 3,156,956        | 1,838,789        | 2,246,696        |
| Të bartura nga viti paraprak <sup>4</sup> - | 0                 | 0                          | 0                | 0                | 17,062           |
| Të hyrat vetjake <sup>5</sup>               | 42,888            | 50,000                     | 0                | 0                | 0                |
| Fondi zhvillimor në mirëbesim               | 0                 | 140,000                    | 0                | 0                | 0                |
| Donacionet e jashtme                        | 0                 | 349,458                    | 268,467          | 859,523          | 0                |

Buxheti final në raport me fillestar ishte rritur për 824,468€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve të jashtme me 349,458€, të hyrat vetjake 50,000€ dhe Fondi zhvillimor i bartur nga viti paraprak 140,000€, si dhe i rritjes së aplikuar pas rishikimit buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë në vlerë 370,786€.

Në vitin 2016, Komuna ka përdorur 81% të buxhet final ose 3,425,423€, me një përmirësim prej 5% krahasuar me vitin 2015. Megjithatë, realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

**Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

| Përshkrimi  | Buxheti fillestar | Buxheti Final    | 2016 Realizimi   | 2015 Realizimi   | 2014 Realizimi   |
|---|-------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| <b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b> | <b>3,402,869</b>  | <b>4,227,337</b> | <b>3,425,423</b> | <b>2,698,312</b> | <b>2,263,758</b> |
| Pagat dhe Mëditjet                                      | 2,260,000         | 1,133,336        | 1,008,206        | 931,273          | 1,834,338        |
| Mallrat dhe Shërbimet                                   | 190,064           | 282,478          | 209,460          | 225,713          | 77,505           |
| Shërbimet komunale                                      | 60,000            | 2,257            | 2,257            | 44,698           | 27,351           |
| Subvencionet dhe Transferet                             | 40,000            | 69,770           | 69,770           | 78,000           | 0                |
| Investimet Kapitale                                     | 852,805           | 2,739,496        | 2,135,730        | 1,418,628        | 324,564          |

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti për investime kapitale ishte rritur për 1,886,691€, si rezultat i implementimit të Fondit zhvillimor në Mirëbesim dhe donacioneve të jashtme. Pavarësisht rritjes së buxhetit për shpenzime kapitale gjatë vitit, vetëm 78% e buxhetit ishte shpenzuar. Programi për Investime Publike përfshin dy projekte në vazhdim nga viti i kaluar dhe tre projekte të reja për vitin aktual. Megjithatë, projekti për “Ndërtimi i rrugëve lokale të komunës” i

<sup>3</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

<sup>4</sup> Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>5</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

nënshkruar në vitin 2015 si kontratë kornizë tre vjeçare në vlerë 3,000,000€, në vitin 2016 janë kryer dhe paguar punë në vlerë 480,561€. Progresi i ekzekutimit të projektit nuk ishte në nivelin e pritur. Më tutje, projekti në vlerë 94,985€ për “Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme” i financuar nga Fondi zhvillimor në mirëbesim nuk kishte filluar së zbatuari, ndonëse komuna ka paguar vlerën prej 75,235€. Në anën tjetër, projekti<sup>6</sup> tjetër në vlerë 200,000€, që ishte miratuar nuk kishte filluar fare pasi qeveria i ka tërhequr mjetet financiare;

- Zvogëlimi i buxhetit për paga dhe mëditje për 1,126,664€ është si rezultat i mos pagesës së pagave në sektorin e arsimit. Ndërsa, vlera prej 125,130€ e pa shpenzuar, është si rezultat i vendimit të komunës për mos pagimin e pagave të sektorin e arsimit;
- Rritja e buxhetit për mallra dhe shërbime përfshin bartjen e mjeteve prej 57,743€ nga shpenzimet komunale si dhe nga granti qeveritar 34,671€. Sidoqoftë ekzekutimi prej vetëm 74% i buxhetit final është për shkak të planifikimit të dobët buxhetor. Pavarësisht kësaj, niveli i detyrimeve të papaguara ishte 24,237€; dhe
- Buxheti për komunalitet ishte reduktuar për 57,743€. Kjo shumë ishte alokuar për investime kapitale dhe mallra e shërbime.

#### Çështja 7 – Realizimi i buxhetit – Prioriteti i lartë

|                      |  |
|----------------------|--|
| <b>E gjetura</b>     | Realizimi i buxhetit nuk ishte në nivelin e pritur. Derisa një pjesë e suficitit ishte jashtë kontrollit të komunës, një pjesë e madhe e shpenzimeve janë bërë në tre mujorin e fund të vitit (1,577,764€). Kjo ka ndodhur për shkak të një planifikimi të dobët dhe të pabazuar në objektiva të caktuara. Performancë e dobët buxhetore vërehet kryesisht te investimet kapitale dhe mallrat dhe shërbimet. Planifikimi i të hyrave është mbivlerësuar ndërsa inkasimi dhe shfrytëzimi i tyre paraqet një prej sfidave kryesore të komunës. |
| <b>Rreziku</b>       | Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe realizimi i ulët i tij do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës.   |
| <b>Rekomandimi 7</b> | Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku planifikimet fillestare të buxhetit janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.  |

<sup>6</sup> Projekti “Stacioni i fabrikës së ujit në bazenet e qendrës sportive Nr i Projektit 41882

### 3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna në 2016 ishin në vlerë 2,078€. Burimet e arkëtimit të hyrave vetjake janë të kufizuara vetëm në këto kategori: nga taksat administrative dhe nga taksat për certifikata të lindjes, martesës dhe vdekjes. Komuna ende nuk është duke mbledhur të hyrat nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, si dhe shfrytëzimi i pronave publike.

#### Çështja 8 - Mungesa e rregulloreve të brendshme dhe arkëtimi i dobët i të hyrave - Prioritet i lartë

**E gjetura** Testimi ynë ka gjetur se Komuna e Leposaviqit nuk ka vendosur një sistem për menaxhimin e të hyrave vetjake. Si rezultat i mungesës së këtij sistemi janë paraqitur mangësitë në vijim:

- Komuna nuk është duke zbatuar ligjin për tatimin në pronë dhe ligjin për ndërtimet, si dy burime kryesore të të hyrave. Si pasojë nuk ka realizuar të hyra nga tatimi në pronë, respektivisht nga lejet e ndërtimit, prandaj edhe niveli i mbledhjes së të hyrave vetjake simbolik;
- Arkëtimi i të gjitha të hyrave ende bëhet në para të gatshme dhe nuk deponohen rregullisht në llogari bankare, ndërsa evidencat mbahen në mënyrë manuale; dhe
- Komuna ende kryen arkëtimin e të hyrave duke u bazuar në një vendim nga koha e UNMIK-ut. Për më tepër, ky vendim nuk parasheh të hyrat nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, shfrytëzimin e pronave publike apo burime tjera të të hyrave komunale.

**Rreziku** Mos zbatimi i ligjeve për mbledhjen e tatimeve dhe taksave për leje të ndërtimit nga ana e menaxhmentit të komunës në arkëtimin e të hyrave vetjake pasqyron një qasje jo serioze të menaxhmentit për të përfituar nga shërbimet e ofruara dhe rritjen e nivelit të të hyrave, por edhe të sigurisë dhe mirëqenies së qytetarëve.

**Rekomandimi 8** Kryetari duhet të sigurojë që është ndërmarrë një shqyrtim kritik në trajtimin e të hyrave dhe vendosjen e një sistemi të përshtatshëm të kontrollit për të mbështetur mbledhjen dhe menaxhimin e të hyrave. Më tej, komuna duhet të siguroj zbatimin e ligjit për tatimin në pronë dhe të ndërtimit, i cili ka për qëllim në radhë të parë zbatimin e kërkesave minimale ligjore, dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve.

### 3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave janë: a) Kontrolli i pagesave çdo muaj, përmes azhurnimit dhe nënshkrimit të listës së pagave, b) Kontrollin e ndryshimeve të mundshme të cilat mund të paraqiten në formularë, c) Shqyrtimin e buxhetit për atë kategori dhe harmonizimet me Thesarin. Buxheti final për paga dhe mëditje në vitin 2016 ishte 1,133,336€. Prej tyre ishin shpenzuar 1,008,206€.

#### Çështja 9 – Dobësi në menaxhimin e personelit – Prioritet i lartë

- E gjetura** Menaxhmenti nuk i ka zbatuar kontrollet ekzistuese në mënyrë efektive, siç kërkohet me ligjin dhe rregulloret aktuale. Auditimi ynë ka konfirmuar vazhdimin e dobësive lidhur me menaxhimin e personelit në Komunë. Për shkak të kontrolleve jo-efektive, menaxhimi i personelit shoqërohet me dobësitë në vijim:
- Menaxhmenti ende nuk ka vendosur një strukturë organizative, sistematizim të vendeve të punës dhe harmonizimin e saj me nevojat dhe buxhetin e komunës. Kjo ka ndikuar që disa vende pune kyçe të mos plotësohen me staf;
  - Për shkak të mungesës së një menaxheri të personelit, dosjet e personelit janë të pakompletuara. Kjo pasqyron një mungesë të specifikave të qarta për stafin e BNP që ndërlidhen me zbatimin e kërkesave të UA-ve si pjesë e përshkrimit të detyrave të tyre të punës; dhe
- Rreziku** Mos emërimi i menaxherit të burimeve njerëzore, do të ndikoj në mos mbajtjen në rregull të dosjeve të punonjësve. Për më tepër, listat e pagave mund të mbesin të pa azhurnuara në baza mujore.
- Rekomandimi 9** Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime për t'i adresuar si çështje urgjente çështjet e përmendura më lart, vendet kyçe të punës duhet të plotësohen me personelin adekuat dhe të azhurnohen dosjet e personelit, në mënyrë që të sigurohet cilësi në menaxhimin e burimeve njerëzore.

### 3.1.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime, si dhe shpenzime komunale në vitin 2016 ishte 284,735€. Prej tyre ishin shpenzuar 211,717€. Ato kanë të bëjnë me furnizim me pajisje dhe inventar, materiale të zyrës, shërbime kontraktuese, derivate etj.

#### Çështja 10 - Dobësitë në menaxhimin e kontratës dhe pagesave- Prioriteti i lartë

**E gjetura** Në kontratën e datës 29/11/2016 për renovimin dhe adoptimin e disa ambienteve brenda ndërtesës së komunës në vlerë 18,305€, komisioni për pranimin e punëve kishte nënshkruar raportin e pranimin të punëve. Në bazë të këtij raporti ishte kryer edhe pagesa e tërësishme e punëve. Megjithatë, nga verifikimi fizik i kryer nga auditimi është konstatuar se disa pozicione (renovimi i dy banjove) të punëve nuk ishin kryer. Kryetari i komunës, përmes menaxherit të projektit ka kontaktuar Operatorin Ekonomik (OE), i cili ka filluar të kryej punët e pa përfunduara. Deri në kohën e auditimit, punët në terren nuk ishin kryer ende.

Komuna më 04.08.2014 kishte nënshkruar kontratë me Operatorin Ekonomik për furnizimin me karburante. Në nenin 4.3 të kontratës ishte përcaktuar që ndryshimet e çmimeve<sup>7</sup> do të bëhen në baza ditore, në përputhje me ndryshimet në çmimin e naftës në bursat ndërkombëtare. Megjithatë, kjo dispozitë e kontratës nuk është zbatuar.

**Rreziku** Nënshkrimi i raportit nga komisioni pranues pa u kryer të gjitha punët dhe pagesa e faturës pa u pranuar mallrat dhe punët, rritë rrezikun për pagesa të parregullta dhe humbje financiare për komunën.

Pagesat pa u siguruar dëshmi të mjaftueshme për furnizimin me çmimin aktual mund të ndikoj në pagesa të parregullta dhe mos marrje të furnizimeve/shërbimeve për vlerën e paguar dhe rritë rrezikun për keqpërdorim të fondeve.

**Rekomandimi 10** Kryetari duhet të shtoj kontrollet e brendshme për të siguruar se ajo që është paguar edhe është pranuar nga komuna, në mënyrë që të parandalohen mundësitë e keqpërdorimit dhe të arrihet vlera për paranë. Kryetari duhet të siguroj që çdo pagesë e realizuar është e dokumentuar dhe ekziston pranimi i atyre mallrave apo shërbimeve në bazë të çmimit përkatës dhe kushteve të përcaktuara me kontratë.

<sup>7</sup> Çmimi për karburant dizel dhe benzinë ishte 1,30€/litër

**Çështja 11 Dobësitë në pranimin dhe shpërndarjen e mallrave – prioriteti i mesëm**

**E gjetura** Në dy raste të ndara për blerjen e pajisjeve të TI (vlera e përgjithshme 14,000€) dhe në një rast për veshmbathje të punëtorëve (vlera 3,841€), sipas dokumentacionit të prezantuar komuna kishte kryer pranimin e këtyre pajisjeve dhe veshmbathjeve. Këto pajisje, sipas shpjegimeve të menaxhmentit, nuk iu janë shpërndarë shfrytëzuesve përfundimtar për shkak se ata kishin refuzuar t'i pranonin ato, ndërsa për veshmbathjet sipas komunës ato ishin të papërshtatshme dhe ishin kthyer tek furnizuesi për përmirësim. Megjithëkëtë, edhe gjatë kohës së auditimit tonë, kjo çështje ende nuk kishte përfunduar. Për më tepër këto pajisje as nuk ishin regjistruar në regjistrat e pasurive të komunës.

**Rreziku** Për shkak të kontrolleve të dobëta të brendshme mund të ndodh që ajo që është paguar edhe të mos pranohet dhe do të rezultojë me vlerë të dobët për paranë. Për më tepër, mos regjistrimi i pasurive të blera mund të rezultojë me tjetërsim dhe humbje fizike të tyre.

**Rekomandimi 11** Kryetari duhet të vendosë kontrolle të brendshme adekuate për të siguruar vlerën për paranë dhe ajo që është paguar të pranohet dhe të shfrytëzohet nga komuna, në mënyrë që shërbimet ndaj qytetarëve të përmirësohen. Më tutje, duhet të sigurohet që pasuria e blerë të regjistrohet në regjistrat e pasurive të komunës.

**3.1.4 Subvencionet dhe transferet**

Buxheti final për subvencione dhe transfere për vitin 2016 ishte 69,770€ dhe po aq ishin shpenzuar. Ato ndahen kryesisht për entitete publike, entitete jo publike dhe përfitues individual. Shembuj të subvencioneve janë bursat për studentë dhe nxënës, subvencione për sport, ndihmë për rastet sociale, subvencione në bujqësi, etj.

**Çështja 12 – Menaxhimi i ndarjes së subvencioneve - Prioritet i lartë**

**E gjetura** Ne kemi konfirmuar se Komuna ende nuk e ka adresuar rekomandimin e AP-së për të nxjerrë një rregullore e cila i përcakton kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve. Në mostrat e testuara në vlerë 19,200€ për dhënien e subvencioneve, nuk është vërejtur ndonjë kriter për mënyrën e dhënies dhe shfrytëzimit të atyre mjeteve.

**Rreziku** Ndarja e subvencioneve pa nxjerrjen Rregulloren për subvencione nga Kuvendi Komunal, rrit rrezikun që subvencionet të ndahen pa kriteret dhe në bazë të interesave të ndryshme.

**Rekomandimi 12** Kryetari duhet të sigurojë që një draft-rregullore për ndarjen e subvencioneve do të përgatitet deri në fund të vitit 2017, e cila do t'i dorëzohet Kuvendit Komunal për aprovim. Në këtë rregullore duhet të përcaktohen qartë kriteret për dhënien e subvencioneve dhe mekanizmat se si do të monitorohen dhe menaxhohen ato. Kontrollat mbi ndarjen e subvencioneve duhet të forcohen për të siguruar monitorim efektiv të shfrytëzimit të mjeteve të ndara nga buxheti i komunës.



---

### 3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 2,739,495€. Prej tyre, në vitin 2016 ishin shpenzuar 2,135,730€, dhe atë kryesisht për: investime në ndërtimin e infrastrukturës rrugore, Investime në objekte kapitale të shëndetësisë, arsimit etj. Komuna ka financuar projektet e saj nga fondet e grantit qeveritar (859,882€), fondit të posaçëm për zhvillim (1,086,000€) dhe nga donacionet (189,849€).

---

#### Çështja 13 – Menaxhimi i kontratës dhe i pagesave – Prioritet i lartë

- E gjetura** Tek Kontrata “Mbështetja për zhvillimin e Ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe zhvillimin e bujqësisë” e nënshkruar më 12.07.2016 në vlerë 94,985€, mjetet janë siguruar nga “Fondi zhvillimor”. Për implementimin e këtij projekti është kontraktuar Agjencia për Zhvillimin Rajonal - Veri (AZhR). Në të njëjtën ditë të nënshkrimit të kontratës (12.07.2016) është bërë edhe kërkesa për transfer të mjeteve në vlerë 14,236€. Komuna ka kryer transferin më 19.08.2016 vetëm në bazë të kërkesës nga AZhR, pa ofrim të dëshmisë dhe arsytimit se pse paguhen këto mjete, si dhe mënyrën se si do të shpenzohen ato mjete. Në të njëjtën mënyrë është kryer edhe një pagesë në dhjetor 2016 në vlerë 61,100€. Totali i dy pagesave arrin vlerën 75,336€ apo 79% të kontratës. Komuna nuk ka krijuar mekanizma për mënyrën e zbatimit të projektit dhe arsytimit të shpenzimit të mjeteve.
- Rreziku** Pagesat pa dëshmi dhe dokumentacion të pa kompletuar tregojnë për kontrolle të dobëta menaxheriale dhe vlerë të dobët për paranë. Në anën tjetër, komuna nuk ka siguri se projekti do të realizohet dhe kjo mund të rezultojë në humbje të parasë dhe dështimin e objektivave të përcaktuara.
- Rekomandimi 13** Kryetari duhet të siguroj mekanizma adekuate për menaxhim të projekteve komplekse dhe mbikëqyrje të pagesave për projektet të cilat ende nuk kanë filluar dhe të siguroj se projektet do të përfundohen sipas rregullave të parapara.



#### Çështja 14 Mos emërimi i menaxherit të projektit dhe mungesa e planit për menaxhimin e projekteve - Prioriteti i lartë

**E gjetura** Tek kontrata Kornizë 3 vjeçare “Ndërtimi i rrugëve të qytetit dhe rrugëve lokale”<sup>8</sup>, e nënshkruar më 27.07.2015 komuna ka realizuar pesë (5) projekte në vlerë 480,561€. Dobësitë e vërejtura në realizimin e projekti:

- komuna nuk ka përgatitur një plan për menaxhimin e projekteve dhe nuk ka emëruar menaxherin e projektit, për të siguruar ekzekutimin e kontratës në mënyrë efektive dhe me performancë në përputhje me Kontratën;
- mungon plani detaj i projekteve dhe nuk janë dhënë me kontratë paramasat dhe parallogaritë se sa njësi do të kryhen për secilin pozicion dhe nuk dihet saktë kostoja e tërë projektit;
- te disa projekte nuk ka plan dinamik për projekte, si dhe mungojnë ditarët e ndërtimeve; dhe
- kontratat kornizë mund të lidhen për mirëmbajtje të rrugëve por jo për ndërtimin e tyre.

**Rreziku** Mangësitë e përmendura kanë ndikim në realizimin e projekteve. Mos përcaktimi detaj i projektit krijon paqartësi se çka do të ndërtohet, sa do të ndërtohet dhe me çfarë kualiteti do të kryhen të gjitha punët. Të gjitha këto projekte mund të rezultojnë me vlerë të dobët për parane.

**Rekomandimi 14** Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim për gjetjet e auditimit për këto raste, ku proceset nuk janë aplikuar në mënyrë efektive për të përcaktuar se pse kanë ndodhur dështimet dhe pse nuk është aplikuar mbikëqyrja e përshtatshme. Kryetari duhet të ketë parasysh vlerën për parane sidomos për projekte të kushtueshme kapitale. Më tutje, kryetari duhet të ndërmarr masa për eliminimin e këtyre dobësive pasi kontrata do të zgjas deri në vitin 2018. Për ndërtimin e rrugëve duhet të lidhen kontrata të veçanta për projektet konkrete.

<sup>8</sup> Sipas kësaj kontrata janë paraparë edhe riparimi i rrugëve

## 3.2 Pasuritë

### 3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Pasuritë kapitale janë të gjitha pasuritë në pronësi të komunës me kosto mbi 1,000€, ndërsa ato jo kapitale janë me vlerën nën 1,000€. Komuna në krahasim me vitet e shkuara këtë vit ka shënuar progres në menaxhimin e pasurive, duke caktuar një zyrtar për menaxhimin e pasurive dhe pas sugjerimeve tona në dhjetor të vitit 2016, ka themeluar komisionin për regjistrimin e pasurive. Me gjithë punën e kryer në vitin 2016 komuna ende ka sfida në identifikimin dhe regjistrimin e pasurive.

#### Çështja 15 – Regjistrimi dhe menaxhimi i pasurive - Prioritet i lartë

**E gjetura** Me gjithë progresin në regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive, komuna ende ka sfida në këtë fushë. Komuna ka regjistruar pasuritë e blera në vitin 2016 (regjistër të brendshëm), por jo edhe të viteve të kaluara. Megjithatë, modulin e pasurisë në SIMFK, komuna ende nuk e ka përdorur. Nga mostra që kemi marrë kemi vërejtur se objektet e ndërtuara, laptopët dhe pajisjet tjera të Teknologjisë Informative dhe pajisjet e mjekësisë, nuk ishin paraqitur në regjistrin e pasurive dhe nuk janë shpalosur në PFV. Po ashtu, komuna nuk është duke përdorur sistemin e-pasuria për regjistrimin e pasurisë jo-financiare nën 1000€.

Më tutje, komuna nuk mbanë evidenca të rregullta ditore dhe mujore për automjetet e komunës lidhur me sasinë e kilometrave të kaluara dhe shpenzimit të karburanteve.

**Rreziku** Mos regjistrimi i plotë i pasurive në regjistrat e brendshëm dhe në SIMFK, rezulton në mos paraqitjen e drejtë dhe faktike të pasurive në PFV. Po ashtu, kjo situatë rritë rrezikun për humbje, tjetërsim apo edhe keq menaxhim të pasurive. Në anën tjetër mos mbajtja e një evidence adekuate të përdorimit të automjeteve zyrtare dhe kilometrave të kaluar me to, rritë rrezikun e keqpërdorimit të pasurive të komunës dhe humbjeve financiare për shkak të përdorimit jo racional dhe të pa kontrolluar të pasurive komunale.

**Rekomandimi 15** Kryetari duhet të analizojë arsyet për mos regjistrimin e të gjitha pasurive në vitin 2016 dhe të atyre nga vitet paraprake. Kryetari duhet të sigurojë që puna e kryer nga komisioni për regjistrimin e pasurive do të monitorohet sistematikisht, dhe nëse kërkohet, do të ndërmerren veprime shtesë për të konfirmuar plotësinë dhe saktësinë e vlerave të pasurive në PFV-të e vitit 2017 dhe më tutje. Përveç kësaj, procesi i regjistrimit të pasurive dhe pronave tjera të paregjistruara duhet të vazhdoj, dhe zyrtari për regjistrimin e pasurive duhet ta udhëheqë këtë proces. Gjithashtu, komisionet e inventarizimit duhet të kryejnë inventarizimin e gjithë pasurisë komunale. Më tutje, kryetari duhet të siguroj hartimin e një rregulloreje të brendshme për përdorimin e automjeteve zyrtare, përmes së cilës do të përcaktoj rregulla të qarta për mënyrën e përdorimit të automjeteve dhe evidentimit të shpenzimeve.

### 3.2.2 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Paratë e imta janë fond i vogël i parave që mbahet në përkujdesjen dhe kontrollin e organizatës buxhetore, departamentit ose njësive më të vogla buxhetore varësisht nga ndarjet buxhetore, dhe që shfrytëzohet për të mbuluar shpenzimet me vlerë të vogël (deri 100€). Komuna gjatë vitit 2016 ka shpenzuar për këtë qëllim 5,000€.

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte 188,237€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2017.

#### Çështja 16 - Menaxhimi joadekuat i obligimeve - Prioritet i mesëm

**E gjetura** Nga auditimi ynë kemi vërejtur se gjatë vitit 2016 Komuna nuk kishte raportuar në MF në baza mujore për obligimet financiare, siç kërkohet me rregullën për raportimin e obligimeve dhe të rregullës financiare nr. 01/2013 mbi shpenzimet e parasë publike. Komuna, nuk mban as libër adekuat të protokollit për pranimin e faturave, pasi që faturat e pranuar nuk regjistrohen me një numër protokolli. Gjithashtu, kemi vërejtur se disa fatura të pranuar për shpenzimet e derivateve nuk ishin raportuar në draft PFV-të e komunës, të cilat pas sugjerimit tonë janë shpalosur në PFV-të përfundimtare. Kjo ka ndodhur për shkak se bartësit e drejtorive nuk kanë kuptuar nevojën për konsolidim të plotë dhe raportimin e saktë në baza mujore të faturave të papaguara në MF.

**Rreziku** Kontrolllet e dobëta financiare për obligimet e pa paguara të komunës, mos raportimi i rregullt mujor i obligimeve, si dhe mos zbatimi i rregullave financiare mund të rezultojë me pagesa të paplanifikuara me buxhetin e ardhshëm të komunës dhe/apo pagesa të dyfishta. Kjo mund ta çojë komunën në vështirësi buxhetore dhe në dështim të arritjes së objektivave vjetore operative.

**Rekomandimi 16** Kryetari duhet të forcojë kontrollat lidhur me pranimin e faturave dhe pagesën e tyre brenda afatit ligjor, për të siguruar që departamenti i financave do të krijojë një sistem efektiv dhe se të gjitha faturat e papaguara brenda afatit 30 ditësh të raportohen në mënyrë të saktë dhe plotë dhe si të tilla të shpalosen në PFV-të e komunës.

---

## Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

## Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

### Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

*Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit*

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.



## Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

| Komponenti i Auditimit            | Rekomandimet e dhëna  | Të zbatuara                       | Në proces të zbatimit   | Të pa zbatuara  |
|-----------------------------------|---|-----------------------------------|---|---|
| 1.5. Pasqyrat Financiare          | <p><b>Rekomandimi 1</b> Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për paraqitjen e gabimeve të përhapura në PFV që kanë rezultuar me modifikim të opinionit. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në PFV-të e vitit 2016 dhe për të siguruar një regjistrim dhe shpalosje të plotë dhe të saktë të pasurive komunale.</p> <p><b>Rekomandimi 2</b> Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2016 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet, përveç nëse ndaj draft PFV janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme dhe janë nënshkruar edhe nga Kryetari i Komunës.</p> | Rekomandimi 1 është implementuar. | Rekomandimi 2 është implementuar pjesërisht. Gabimet në PFV janë evituar, por ka çështje tjera në lidhje me pagesat e gabuara të shpenzimeve si dhe mos shpalosja e plotë e pasurive. |   |
| 2.3 Rekomandimet e vitit paraprak | <p><b>Rekomandimi 3</b> Kryetari duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili përcakton saktë veprimet dhe afatet kohore për implementim e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Një proces i vazhdueshëm i monitorimit, gjithashtu, duhet të jetë pjesë përbërëse e këtij procesi.</p>   |                                   |   | Nuk janë marrë masa, pasi vetëm dy nga 17 rekomandimet janë implementuar. |

|  |   |  |  |  |
|--|---|--|--|--|
| 2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së. | <b>Rekomandimi 4</b> Kryetari duhet të sigurojë që lista kontrolluese e vetëvlerësimit për vitin 2016 do të plotësohet dhe dorëzohet në MF. Para dorëzimit në MF ajo duhet të rishikohet dhe përgjigjet e ofruara të konfirmohen. Kryetari duhet të iniciojë gjithashtu aktivitetet për përgatitjen e një plani zhvillimor komunal i cili duhet të jetë e gatshëm për zbatim nga viti 2017. Ky plan duhet të shoqërohet me një kosto që përkon me burimet komunale dhe me mekanizma efektiv që sigurojnë zbatimin e saj dhe arritjen e rezultateve. |  |  | Nuk janë marrë masa, sepse Komuna nuk ka plotësuar listën kontrolluese të vet-vlerësimit.  |
| 2.5.1 Aranzhimet e llogaridhënies                  | <b>Rekomandimi 5</b> Kryetari duhet t'i analizojë arsyet e ngecjes së procesit të konsolidimit të brendshëm të komunës dhe të sigurojë që dobësitë e identifikuar të adresohen brenda vitit 2016. Kryetari, në bashkëpunim me MF-në, duhet të aranzhojë një program trajnimit të zyrtarëve komunal për certifikimin e tyre në fushën e shpenzimeve, në mënyrë që procesi i shpenzimeve të menaxhohet nga vet Komuna.  |  | vetëm sa i përket trajnimit të zyrtarëve komunal për certifikimin e tyre në fushën e shpenzimeve, në mënyrë që procesi i shpenzimeve të menaxhohet nga vet Komuna. |  |
| 2.5.2 Vlerësimi i rrezikut.                        | <b>Rekomandimi 6</b> Kryetari duhet të sigurojë se identifikimi, vlerësimi i rrezikut dhe masat për reduktimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, shqyrtohen në nivelet më të larta të menaxhmentit. Më tej, duhet të sigurohet se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut në një drejtori përkatëse, i cili në koordinim me udhëheqësit e njësive do të menaxhojë këtë proces dhe do të raportojë në baza të rregullta rreth menaxhimit të rreziqeve.   |  |  | Nuk janë marrë masa. Komuna ende nuk e ka një listë të rreziqeve, si dhe një plan për menaxhimin dhe reduktimin e rreziqeve në nivele të pranueshme. |



|  |  |  |  |  |
|--|--|--|--|--|
| 2.5.3 Raportimi menaxherial.                                     | <b>Rekomandimi 7</b> Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri në fund të vitit 2016.   |  |  | Nuk janë marrë masa. Komuna ende ka një raportim të dobët financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat tek menaxhmenti i lartë.                           |
| 2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm.                            | <b>Rekomandimi 8</b> Kryetari duhet të merr në konsiderim rekrutimin e një auditori të brendshëm i cili përmes një programi gjithëpërfshirës të punës do të inkorporonte rreziqet financiare dhe të tjera të komunës dhe do të vlerësonte efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Përveç kësaj, ne sugjerojmë që të themelohet edhe një Komitet efektiv i Auditimit i cili duhet të rishikojë në mënyrë kritike planet dhe rezultatet e auditimit të brendshëm.   |  |  | Nuk janë marrë masa. Komuna ende nuk ka arritur që të siguroj shërbimet e auditimit të brendshëm, si dhe nuk e ka themeluar Komitetin e auditimit. |
| 3.3 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit.                        | <b>Rekomandimi 9</b> Kryetari duhet të sigurojë që planit të inkasimit të të hyrave i paraprinë një analizë e mirëfilltë dhe që performanca buxhetore monitorohet në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final dhe në kërkesat buxhetore për periudhat e ardhshme.                                 |  |  | Nuk janë marrë masa pasi komuna ende ka një performancë të dobët të realizimit të buxhetit.  |
| 3.4 Prokurimi<br>Dobësi sistematike në kontratat publike kornizë | <b>Rekomandimi 10</b> Kryetari duhet t'i analizojë shkaqet pse nuk ishin plotësuar kërkesat e prokurimit dhe pse kanë ndodhur parregullsitë e identifikuar. Kryetari duhet t'i forcojë kontrollet e prokurimit dhe të sigurojë që të gjitha proceset e prokurimit do të zhvillohen në pajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe që kontratat me operatorët do të jenë të qarta dhe të plota. Pagesat duhet të ekzekutohen vetëm atëherë kur konfirmohet që të gjitha punët dhe pozicionet janë kryer në përputhje me kontratën. |  |  | Nuk janë marrë masa, sepse ka ende parregullsi në proceset e prokurimit.   |

|   |   |                     |  |   |
|---|---|---------------------|--|---|
| 3.4 Prokurimi<br>Dobësi jo-sistematike                | <b>Rekomandimi 11</b> Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha shërbimet ku kërkohet procedurë e prokurimit do të kontrahohen vetëm përmes procedurave adekuate të prokurimit. Kontrollat e mbikëqyrjes së projekteve duhet të forcohen për të siguruar që të gjitha pagesat bëhen vetëm pas konfirmimit që punë janë kryer. Kryetari duhet të sigurojë ndarje të detyrave në proceset e prokurimit për të siguruar objektivitet të plotë të vlerësimeve të tenderëve. Njëkohësisht të gjitha shpenzimet duhet të paguhen nga kategoritë adekuate ekonomike për të parandaluar keq-klasifikimin e shpenzimeve. |                     |  | Nuk janë marrë masa, sepse ende ekzistojnë dobësitë në aplikimin e procedurave të prokurimit.   |
| 3.4 Prokurimi<br>Shmangia e procedurave të prokurimit | <b>Rekomandimi 12</b> Kryetari duhet të analizojë arsyeshmërinë e përdorimit të kuotimeve për blerjet e natyrës së njëjtë, me theks të veçantë në rastet kur për vlerën e përgjithshme parashihet procedurë të hapur. Kryetari duhet të forcojë kontrollat në planifikimin dhe realizimin e prokurimit duke siguruar që për shpenzimet e natyrës së njëjtë do të përdoren procedurat e hapura për të arritur vlerën më të lartë për paranë e paguar.  |                     |  | Nuk janë marrë masa në aplikimin e procedurave të duhura të prokurimit.   |
| 3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit                   | <b>Rekomandimi 13</b> Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha shërbimet lidhur shëndetin publik kryhen dhe paguhen vetëm në institutet e licencuara nga organet kompetente të Kosovës.  | Është implementuar. |  |   |
| 3.2.2 Kompenzimet (pagat dhe mëditjet)                | <b>Rekomandimi 14</b> Kryetari duhet t'i analizojë shkaqet e vonesave në emërimin e zyrtarëve kyç për menaxhimin e personelit dhe të sigurojë që këto pozita do të plotësohen më së largu deri në fund të vitit 2016. Kryetari duhet të sigurojë që kontrollat për menaxhimin e stafit janë vendosur për të parandaluar gabimet potenciale dhe humbjet e mëtejme financiare të komunës.   |                     |  | Nuk janë marrë masa, pasi komuna vazhdon të mos ketë Menaxher të personelit, dhe kontrollat për menaxhimin e stafit ende nuk janë vendosur. |

|   |   |          |  |  |
|---|---|----------|--|--|
| 3.5.3<br>Subvencionet dhe transferet      | <b>Rekomandimi 15</b> Kryetari duhet të sigurojë që një draft-rregullore për ndarjen e subvencioneve do të përgatitet deri në fund të vitit 2016 dhe t'i dorëzohet Kuvendit Komunal për aprovim. Kontrollat mbi ndarjen e subvencioneve duhet të forcohen për të siguruar monitorim efektiv të shfrytëzimit të mjeteve të ndara nga buxheti i komunës.  |          |  | Nuk janë marrë masa. Komuna edhe në vitin 2016 vazhdon të mos ketë një rregullore për subvencionet.  |
| 3.6 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake) | <b>Rekomandimi 16</b> Kryetari duhet të iniciojë menjëherë hartimin e një rregulloreje për taksa, tarifa dhe ngarkesa dhe të njëjtën t'ia kalojë për miratim Kuvendit Komunal. Ne do të sugjeronim një bashkëpunim me komunat tjera që mund të shërbejnë si shembull i mirë në këtë fushë dhe të shfrytëzohen praktikat e mira për të lehtësuar tërë procesin. Gjithashtu, Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha llojet e taksave dhe tatimeve në këtë rregullore të zbatohen si në komunat tjera të Kosovës. Ky proces duhet të monitorohet vazhdimisht nga ana e Kryetarit me qëllim që të zbatohen kërkesat ligjore.             |          |  | Nuk janë marrë masa, sepse ende nuk është hartuar një rregullore për taksa, tarifa dhe ngarkesa. Gjithashtu komuna ende nuk është duke mbledhur të gjitha llojet e taksave dhe tatimeve. |
| 3.7 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale     | <b>Rekomandimi 17</b> Kryetari duhet me urgjencë ta trajtojë procesin e regjistrimit të pasurive. Hapi i parë në këtë drejtim duhet të jetë emërimi i një zyrtari për pasuri dhe më pas të vazhdohet me identifikimin dhe regjistrimin e pasurive komunale në regjistrin kontabël. Inventarizimi vjetor i pasurive në dispozicion duhet të kryhet në bazë vjetore në përputhje me Rregullën Financiare 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive. Duhet të nxirren udhëzime të qarta për të kontrolluar shfrytëzimin e pasurive publike, duke përfshirë posaçërisht veturat, pajisjet kompjuterike, telefonat, lokalet dhe hapësirat publike. |          | Komuna ka regjistruar pasuritë e blera në vitin 2016 (regjistër të brendshëm), por jo edhe të viteve të kaluara. |  |
| <b>Numri i rekomandimeve:</b>             |   | <b>2</b> | <b>3</b>   | <b>12</b>  |

## Shtojca IV: Letër e Konfirmimit

KOMUNA LEPOSAVIQ



### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: Leposaviq, 17.05.2017

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Leposaviqit, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kryetari:

Dragan Jablanovic

